

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shkurt 2024


Tiranë, më 25 Mars 2024: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Shkurt 2024, janë 981.295. Ky tregues rezulton me një rritje 41,1 %, krahasuar me Shkurt 2023. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2024, janë 1.002.781, duke shënuar një rritje me 44,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve

Në Shkurt 2024, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 500.756. Ky numër është rritur me 29,8 %, krahasuar me Shkurt 2023.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 480.539. Ky numër është rritur me 55,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 (fig.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Shkurt 2023- Shkurt 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 25/03/2024

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2024 janë 507.095. Krahasuar me Shkurt 2023, ky tregues është rritur me 30,1 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shkurt 2024, janë 495.686. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është rritur me 63,4 % (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Ndryshimi vjetor %	Janar - Shkurt 2023	Janar - Shkurt 2024	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	695.246	981.295	41,1	1.528.696	2.011.309	31,6
Shqiptarë	385.921	500.756	29,8	842.160	1.041.171	23,6
Të Huaj	309.325	480.539	55,4	686.536	970.138	41,3
Dalje Gjithsej	693.021	1.002.781	44,7	1.647.954	2.220.465	34,7
Shqiptarë	389.654	507.095	30,1	931.767	1.151.863	23,6
Të Huaj	303.367	495.686	63,4	716.187	1.068.602	49,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Shkurt 2024 rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 459.700 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore dhe Paqësori, përkatësisht me 8.147 dhe 2.979 shtetas (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Janar - Shkurt 2023	Janar - Shkurt 2024
Gjithsej	309.325	480.539	686.536	970.138
I. Afrika	184	914	1.025	1.434
II. Amerika	6.250	8.147	13.301	17.014
III. Azia Lindore dhe Paqësori	1.363	2.979	2.671	5.136
IV. Lindja e Mesme	421	735	866	1.336
V. Azia e Jugut	486	584	974	1.548
VI. Evropa	300.057	459.700	666.314	935.263
- Evropa Qëndrore / Lindore	8.398	20.226	17.092	36.334
- Evropa Veriore	9.680	18.596	17.598	31.317
- Evropa Jugore	262.205	387.776	590.759	807.286
- Evropa Perëndimore	12.567	21.472	25.104	37.086
- Evropa Lindore / Mesdheut	7.207	11.630	15.761	23.240
VII. Rajone të paspecifikuara	564	7.480	1.385	8.407

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Shkurt 2024, krahasuar me Shkurt 2023, hyrjet e shtetasve të huaj shënojnë rritje:

- për qëllime personale me 55,4 %;
- për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 56,9 %;
- për biznes dhe qëllime profesionale me 53,9 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2023	Janar-Shkurt 2024	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje shtetas të huaj	309.325	480.539	55,4	686.536	970.138	41,3
I. Personale	300.913	467.591	55,4	670.519	948.919	41,5
1. Pushime. vizitë tek të afërm. etj.	286.283	449.269	56,9	639.035	910.476	42,5
2. Trajtime shëndetësorë	40	57	42,5	155	109	-29,7
3. Qëllime fetare	37	30	-18,9	58	43	-25,9
4. Udhëtarë transit	14.553	18.235	25,3	31.271	38.291	22,4
II. Biznes dhe profesionale	8.412	12.948	53,9	16.017	21.219	32,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë), Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve, Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë), Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës, Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm,

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm, Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika e Revizionimit Statistikor,](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor_)

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr,71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.